

Data 14/02/2023

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BATIMETRIA E LIQENEVE TË FIERZËS, KOMANIT DHE VAUT TË DEJËS, VLERËSIMI I SEDIMENTEVE DHE VLERËSIMI GJEOLOGJIK I SHPATEVE MALORE”, E NDARË NË LOTE.

LOTI I: “Batimetria e liqenit Fierzë, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”.

LOTI II: “Batimetria e liqeneve të Komanit dhe Vaut të Dejës, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të ndryshme - 98300000-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: 165,334,800 (Njëqind e gjashtëdhjetë e pesëmilion e treqind e tridhjetë e katërmijë e tetëqind) Lekë pa TVSH ose 1,425,300 (njëmilion e katërqind e njëzet e pesëmijë e treqind) Euro.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 14/02/2023 është 116 Lekë/Euro.

LOTI I: “Batimetria e liqenit Fierzë, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”, 106,952,000 (Njëqind e gjashtëmilion e nëntëqind e pesëdhjetë e dymijë) Lekë pa TVSH ose 922,000 (Nëntëqind e njëzet e dymijë) Euro.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 14/02/2023 është 116 Lekë/Euro.

LOTI II: “Batimetria e liqeneve të Komanit dhe Vaut të Dejës, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”, me fond limit 58,382,800 (pesëdhjetë e tetëmilion e treqind e tetëdhjetë e dymijë e tetëqind) Lekë pa TVSH ose 503,300 (Pëseqind e tremijë e treqind) Euro.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 14/02/2023 është 116 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI I: “Batimetria e liqenit Fierzë,vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore ” .

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12.*

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 12.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Kur konkuron për të 2 (dy) Lotet së bashku ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurren.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është "Shërbim Konsulence", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: " 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2019, 2020, 2021 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën

vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Kur konkurrenca për të (2) dy lotet së bashku Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurrenca.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licencë profesionale të vlefshme të shoqërisë për projektim (lëshuar nga MIE ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të

projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”, ku të përfshihen kategorite si me poshtë:

✚ PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE Kat 5:

✚ **Kat 5- a)** Diga të mëdha (diga me lartësi mbi 10 m ose me vëllim të uji të grumbulluar mbi 1 milion m³ ose gjatësi kurore dige mbi 500 ml);

✚ **Kat 5- f)** Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi – shkarkues të ujrave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuaret, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit në puse.

✚ **PROJEKTUES GJEODET Kat 8** a) Rilevime inxhinierike; c) Sisteme GIS; d) Bazamente Gjeodezike; e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

✚ **STUDIME GJEOLLOGO INHINIERIK- HIDROGJEOLOGJIK Kat 9** d) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në projektim, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016 (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Pikat e licensës së kërkuar janë bazuar në shërbimin i cili kërkohet të sigurohet sipas detyrës së projektimit të përgatitur nga specialistët e fushës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë deklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë

pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, siç janë: Kryerja e matjeve batimetrike për liqenin e Fierzës do të kryhet me mjetet e nevojshme të kërkuara (pajisje për matjen e batimetrisë, total station, GPS, dronë) dhe pas kryerjes të matjeve duhet të bëhet e mundur përgatitja dhe përpunimi i të dhënave të gjitha këto procese punë duhet të kryhen nga specialistë të fushës përkatëse.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohë shtrirje Nëntor 2022 – Janar 2023, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e këtij shërbimi duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023 punonjësit si më poshtë:

- ✚ 1 (një) drejtuesi i ekipit duhet të jetë i licencuar në fushën e gjeodezisë me eksperiencë në ndërtimin e rrjeteve topografike, rievimeve topografike, rievimeve batimetrike , me përvojë pune minimumi 10 vjet.
- ✚ 1 (një) Inxhinier gjeodet/markshaidër, me përvojë pune minimumi 5 vjet, i licencuar.
- ✚ 1 (një) inxhinier hidroteknik me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.
- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontrate punë e vlefshme, diplomë, CV, certifikime si dhe licencat profesionale për projektim, sipas **VKM nr. 943, datë 28.12.2016.**

Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën e mësipërme.

***Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

✚ 1 (një) drejtuesi i ekipit duhet të jetë i licencuar në fushën e gjeodezisë me eksperiencë në ndërtimin e rrjeteve topografike, rilevimeve topografike, rilevimeve batimetrike , me përvojë pune minimumi 10 vjet. Drejtuesi i ekipit do të ndjekë të gjitha proceset e shërbimit të kërkuar.

✚ 1 (një) Inxhinier gjeodet/markshaidër, me përvojë pune minimumi 5 vjet, i licencuar.

Këta inxhinier kërkohen bazuar në detyrën e projektimit, ku kërkohet kryerja e batimetrisë së liqenit me standarte bashkëkohore duke kombinuar matje batimetrike të saktësive të larta me matje topografike të rezoluzioneve të larta për liqenin e Fierzës. Gjithashtu monitorimi i sedimenteve, brigjeve dhe i kupave të liqeneve të kaskadës së Drinit në përgjithësi si dhe i zonave problematike në veçanti i cili është qëllimi i kësaj detyre. Për sa i takon eksperiencës së kërkuar për këta inxhinier kjo është bërë referuar shërbimit i cili kërkohet të kryhet, pasi është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon staf të kualifikuar. Gjithashtu bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është shërbim konsulence do të sjell një vlerësim sa më të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit.

1 (një) inxhinier hidroteknik me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.

Ky inxhinier kërkohet bazuar në detyrën e projektimit si dhe në llojin e veprës në të cilën do të kryhet shërbimi e cila është vepër hidroteknike. Inxhinieri hidroteknik do të bëjë të mundur koordinimin e punën rast pas rasti bazuar në grafikun e operimit të veprave hidroteknike të kaskadës. Kjo p.sh. për rastet e realizimit të matjeve batimetrike pranë veprave të marrjes apo atyre të shkarkimit. Për sa i takon eksperiencës së kërkuar për këtë inxhinier kjo është bërë referuar shërbimit i cili kërkohet të kryhet, pasi është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon staf të kualifikuar. Gjithashtu bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është shërbim konsulence do të sjell një vlerësim sa më të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit.

✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.

Ky inxhinier kërkohet bazuar në detyrën e projektimit ku kërkohet të kryhet batimetria e liqenit me standarte bashkëkohore duke kombinuar matje batimetrike të saktësive të larta me matje topografike të rezoluzioneve të larta për liqenin e Fierzës. Gjithashtu kërkohet një informacion i përditësuar të territorit të liqenit të Fierzës, ku të mund të shihen qartazi problematika e mbushjes së liqenit, rrëshqitjeve dhe fenomeneve të tjera gjeologjike, vegjetacioni, prurjeve të ngurta në rezervuare të cilat janë qëllim kryesor i kësaj detyre. Për sa i takon eksperiencës së kërkuar për këtë inxhinier kjo është bërë referuar shërbimit i cili kërkohet të kryhet, pasi është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon staf të kualifikuar. Gjithashtu bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është shërbim konsulence do të sjell një vlerësim sa më të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm:

✚ 3 (tre) ekspertë të grupit topografik të diplomuar në disipinat të cilat kanë lidhje me detyrën dhe preferohen të kenë eksperiencë të mëparshme.

✚ 7 (shtatë) ekspert në fusha të ndryshme të inxhinierisë, duhet të jenë të diplomuar në disipinat të cilat kanë lidhje me detyrën dhe preferohen të kenë eksperiencë të mëparshme. Të kenë njohuri me përpunimin e të dhënave në programe inxhinierike.

✚ 1 (një) ekspert me certifikatë HSE.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

Kontrate punë e vlefshme ose marrëveshje angazhimi, diplomë, CV.

Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën e mësipërme.

***Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

✚ 3 (tre) ekspertë të grupit topografik: Këta punonjës kërkohen bazuar në detyrën e projektimit ku kërkohet të bëhen matjet batimetrike dhe topografike me pajisje për keto matje, GPS,

Total Station, dron, etj të cilat shërbejnë që këto matje të bëhen me saktësi dhe profesionalizëm më të lartë.

✚ 7 (shtatë) ekspert në fusha të ndryshme të inxhinierisë, duhet të jenë të diplomuar në disiplina të cilat kanë lidhje me detyrën dhe preferohen të kenë eksperiencë të mëparshme. Të kenë njohuri me përpunimin e të dhënave në programe inxhinierike.

Këta punonjës kërkohen referuar detyrës së projektimit ku proceset e shërbimeve që do të kryen janë të shumta që nga matjet, përpunimi i të dhënave, kryerja e krahasimeve objekt kontrate.

✚ 1 (një) ekspert me certifikatë HSE (Përgjegjës i sigurisë dhe shëndetit në punë).

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, bazuar në Ligjin 10327 datë 18/02/2010, neni 5, pika 21 nënkupton: "Siguria dhe shëndeti në punë" janë masat e marra, që kanë si synim përmirësimin e kushteve gjatë procesit të punës, ruajtjen e jetës, integritetin e shëndetit, mbrojtjen fizike dhe psikike të punëmarrësve të tjerë....

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) ISO 9001:2015 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë";

b) ISO 14001:2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";

c) ISO 45001:2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë"

ISO 9001:2015 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë" – Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001-2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit" është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politiken mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001:2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë", është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e shërbimit që do kryhet dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- ✚ 2 (dy) Pajisje për matje batimetrie. Minimumi 1 (një) pajisje me 1 (një) matje (singlebeam) me thellësi deri në 100m dhe minimumi 1 (një) pajisje për matjet batimetrike me shumë drejtime në të njëjtën kohë (multibeam) me thellësi deri në 150 m.
- ✚ 3 (tre) pajisje GPS.
- ✚ 2 (dy) pajisje Stacion Total.
- ✚ 1 (një) pajisje Droni i dizajnuar për inspektim, monitorim, detektim i pajisur me LIDAR ose kamera digjitale me një rezolucion të lartë.
- ✚ 2 (dy) mjete transporti uJOR.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

*a) Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh. **Faturë tatimore të shitblerjes ose kontrate qiraje të noterizuar.***

b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit si (çertifikatë lundrimi, siguracionin e mjetit, çertifikatën e kontrollit tekni, dëshmi aftësie për lundim mjete të vogla).

c) Për mjetet e siguruara me qera, dokumentat e mësipërm duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/leasing/huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë

pranë AK dokumentacionin e mësipërm i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI II: “ Batimetria e liqeneve të Komanit dhe Vaut të Dejës, vlerësimi i sedimenteve dhe vlerësimi gjeologjik i shpateve malore”.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklaramit, sipas shtojcës 12.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 12.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Kur konkuron për të 2 (dy) Lotet së bashku ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurren.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është "Shërbim Konsulence", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: " 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2019, 2020, 2021 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Kur konkurren për të (2) dy lotet së bashku Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit të LOTEVE për të cilat ofertuesi konkurren.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i

ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licencë profesionale të vlefshme të shoqërisë për projektim (lëshuar nga MIE ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”, ku të përfshihen kategorite si me poshtë:

✚ PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE Kat 5:

✚ **Kat 5- a)** Diga të mëdha (diga me lartësi mbi 10 m ose me vëllim të ujit të grumbulluar mbi 1 milion m³ ose gjatësi kurore dige mbi 500 ml);

✚ **Kat 5- f)** Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi – shkarkues të ujrave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuaret, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit në puse.

✚ **PROJEKTUES GJEODET Kat 8** a) Rilevime inxhinierike; c) Sisteme GIS; d) Bazamente Gjeodezike; e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

✚ **STUDIME GJEOLLOGO INJINIERIK- HIDROGJEOLOGJIK Kat 9** d) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në projektim, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016 (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Pikat e licensës së kërkuar janë bazuar në shërbimin i cili kërkohet të sigurohet sipas detyrës së projektimit të përgatitur nga specialistët e fushës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë deklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllëguar si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, siç janë: Kryerja e matjeve batimetrike për liqenin e Komanit dhe Vau Dejës do të kryhet me mjetet e nevojshme të kërkuara (pajisje për matjen e batimetrisë, total station, GPS, dronë) dhe pas kryerjes të matjeve duhet të bëhet e mundur përgatitja dhe përpunimi i të dhënave të gjitha këto procese punë duhet të kryhen nga specialistë të fushës përkatëse.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohë shtrirje Nëntor 2022 – Janar 2023 tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e këtij shërbimi duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Nëntor 2022 – Janar 2023, punonjësit si më poshtë:

✚ 1 (një) drejtuesi i ekipit duhet të jetë i licencuar në fushën e gjeodezisë me eksperiencë në ndërtimin e rrjeteve topografike, rievimeve topografike, rievimeve batimetrike , me përvojë pune minimumi 10 vjet.

- ✚ 1 (një) Inxhinier gjeodet/markshaider, me përvojë pune minimumi 5 vjet, i licencuar.
- ✚ 1 (një) inxhinier hidroteknik me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.
- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontrate punë e vlefshme, diplomë, CV, çertifikime si dhe licencat profesionale për projektim, sipas **VKM nr. 943, datë 28.12.2016.**

Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën e mësipërme.

***Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

✚ 1 (një) drejtuesi i ekipit duhet të jetë i licencuar në fushën e gjeodezisë me eksperiencë në ndërtimin e rrjeteve topografike, rlevimeve topografike, rlevimeve batimetrike , me përvojë pune minimumi 10 vjet. Drejtuesi i ekipit do të ndjekë të gjitha proceset e shërbimit të kërkuar.

✚ 1 (një) Inxhinier gjeodet/markshaider, me përvojë pune minimumi 5 vjet, i licencuar.

Këta inxhinier kërkohen bazuar në detyrën e projektimit, ku kërkohet kryerja e batimetrisë së liqenit me standarte bashkëkohore duke kombinuar matje batimetrike të saktësive të larta me matje topografike të rezoluzioneve të larta për liqenin e Komanit dhe Vau të Dejës. Gjithashtu monitorimi i sedimenteve, brigjeve dhe i kupave të liqeneve të kaskadës së Drinit në përgjithësi si dhe i zonave problematike në veçanti i cili është qëllimi i kësaj detyre. Për sa i takon eksperiencës së kërkuar për këta inxhinier kjo është bërë referuar shërbimit i cili kërkohet të kryhet, pasi është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon staf të kualifikuar. Gjithashtu bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është shërbim konsulence do të sjell një vlerësim sa më të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit.

1 (një) inxhinier hidroteknik me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.

Ky inxhinier kërkohet bazuar në detyrën e projektimit si dhe në llojin e vprës në të cilën do të kryhet shërbimi e cila është vepër hidroteknike. Inxhinieri hidroteknik do të bëjë të mundur koordinimin e punën rast pas rasti bazuar në grafikun e operimit të veprave hidroteknike të kaskadës. Kjo p.sh. për rastet e realizimit të matjeve batimetrike pranë veprave të marrjes apo atyre të shkarkimit. Për sa i takon eksperiencës së kërkuar për këtë inxhinier kjo është bërë referuar shërbimit i cili kërkohet të kryhet, pasi është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon staf të kualifikuar. Gjithashtu bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është shërbim konsulence do të sjell një vlerësim sa më të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit.

✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog me përvojë pune minimumi 10 vjet, i licencuar.

Ky inxhinier kërkohet bazuar në detyrën e projektimit ku kërkohet të kryhet batimetria e liqenit me standarte bashkëkohore duke kombinuar matje batimetrike të saktësive të larta me matje topografike të rezoluzioneve të larta për liqenin e Komanit dhe Vau të Dejës. Gjithashtu kërkohet një informacion i përditësuar të territorit të liqenit të Komanit dhe Vau të Dejës, ku të mund të shihen qartazi problematika e mbushjes së liqenit, rreshqitjeve dhe fenomeneve të tjera gjeologjike, vegjetacioni, prurjeve të ngurta në rezervuare të cilat janë qëllim kryesor i kësaj detyre. Për sa i takon eksperiencës së kërkuar për këtë inxhinier kjo është bërë referuar shërbimit i cili kërkohet të kryhet, pasi është i një rëndësie të veçantë dhe kërkon staf të kualifikuar. Gjithashtu bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është shërbim konsulence do të sjell një vlerësim sa më të drejtë nga ana e komisionit të vlerësimit.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm:

✚ 3 (tre) ekspertë të grupit topografik të diplomuar në disipinat të cilat kanë lidhje me detyrën dhe preferohen të kenë eksperiencë të mëparshme.

✚ 7 (shtatë) ekspert në fusha të ndryshme të inxhinierisë, duhet të jenë të diplomuar në disipinat të cilat kanë lidhje me detyrën dhe preferohen të kenë eksperiencë të mëparshme. Të kenë njohuri me përpunimin e të dhënave në programe inxhinierike.

✚ 1 (një) ekspert me çertifikatë HSE.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

Kontrate punë e vlefshme ose marrëveshje angazhimi, diplomë, CV.

Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën e mësipërme.

***Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

✚ 3 (tre) ekspertë të grupit topografik: Këta punonjës kërkohen bazuar në detyrën e projektimit ku **kërkohet të bëhen matjet batimetrike dhe topografike me pajisje për keto matje, GPS, Total Station, dron, etj të cilat shërbejnë që këto matje të bëhen me saktësi dhe profesionalizën më të lartë.**

✚ 7 (shtatë) ekspert në fusha të ndryshme të inxhinierisë, duhet të jenë të diplomuar në disiplinat të cilat kanë lidhje me detyrën dhe preferohen të kenë eksperiencë të mëparshme. Të kenë njohuri me përpunimin e të dhënave në programe inxhinierike.

Këta punonjës kërkohen referuar detyrës së projektimit ku proceset e shërbimeve që do të kryen janë të shumta që nga matjet, përpunimi i të dhënave, kryerja e krahasimeve objekt kontrate.

✚ 1 (një) ekspert me çertifikatë HSE (Përgjegjës i sigurisë dhe shëndetit në punë).

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, bazuar në Ligjin 10237 datë 18/02/2010, neni 5, pika 21 nënkupton: “Siguria dhe shëndeti në punë” janë masat e marra, që kanë si synim përmirësimin e kushteve gjatë procesit të punës, ruajtjen e jetës, integritetin e shëndetit, mbrojtjen fizike dhe psikike të punëmarrësve të tjerë....

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

d) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

e) ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;

f) ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politiken mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”, është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Certifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e shërbimit që do kryhet dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- ✚ 2 (dy) Pajisje për matje batimetrie. Minimumi 1 (një) pajisje me 1 (një) matje (singlebeam) me thellësi deri në 100m dhe minimumi 1 (një) pajisje për matjet batimetrike me shumë drejtime në të njëjtën kohë (multibeam) me thellësi deri në 150 m.
- ✚ 3 (tre) pajisje GPS.
- ✚ 2 (dy) pajisje Stacion Total.
- ✚ 1 (një) pajisje Droni i dizajnuar për inspektim, monitorim, detektim i pajisur me LIDAR ose kamera digitale me një rezolucion të lartë.
- ✚ 2 (dy) mjete transporti ujqor.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- d) Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh. **Faturë tatimore të shitblerjes ose kontrate qiraje të noterizuar.**
- e) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit si (çertifikatë lundrimi, siguracionin e mjetit, çertifikatën e kontrollit tekni, dëshmi aftësie për lundim mjete të vogla).
- f) Për mjetet e siguruara me qera, dokumentat e mësipërm duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/leasing/huapërdorjes e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin e mësipërm i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të përfshira në detyrën e projektimit janë hartuar në mbështetje të dispozitave bazuar në Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, në “Rregulloren e Sigurisë së Digave dhe Dambave” të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 147, datë 18.03.2004.

Njësia e Prokurimit